



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

**NJOFTIM**

**Rasti:** Rasti i përfutimit të kontrollit të shoqërisë SEASIDE RESIDENCE V SHPK nga shoqëria BOLV-OIL SHA.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr. 461 prot. i AK, datë 26.06.2004 “Njoftim paraprak”, nëpërmjet të cilës është njoftuar mbi rastin e përfutimit të kontrollit të shoqërisë SEASIDE RESIDENCE V SHPK nga shoqëria BOLV-OIL SHA.

Referuar dokumenteve të depozituara, palët në transaksion janë:

**Pala blerëse: BOLV-OIL SHA** është një shoqëri aksionare me objekt aktiviteti tregti me shumicë të naftës dhe nënprodukteve të saj, operacione të ndryshme portuale, investime kapitale në fushën e ndërtimit, ndërtime të rrugëve, kanalizimeve dhe objekteve civile dhe industriale, import, eksport dhe tregtim me shumicë i materialeve të ndërtimit, transport rrugor kombëtar e ndërkombëtar i naftës, gazit , nënprodukteve, lëndë djegëse, furnizim me karburant për anije të ndryshme në porte, etj.

Shoqëria BOLV -OIL SHA zotërohet 100% nga Z. Behar Çukaj.

Z. Behar Çukaj zotëron direk dhe indirekt shoqëritë: OLSI SHPK; Porto-Romano OIL SHA; Albdripping SHA dhe AUTOVISION SHA.

**Pala shitëse: GREEN COAST SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Objekti parësor i veprimtarisë së shoqërisë është projektimi, ndërtimi, vënia në shfrytëzim e një kompleksi turistik, një strukturë hotelerie dhe e objekteve turistike sezonale në Palasë. Shitja e objekteve me destinacion rezidencial veror dhe/ose administrimi i tyre, si dhe ofrimi i shërbimeve të hoteleri-turizmit në zonën e Palasës, si dhe çdo veprimtari tjetër plotësuese që lidhet direkt ose indirekt me veprimtarinë e sipërpërmendur etj.

Shoqëria GREEN COAST SHPK zotërohet 100% nga shoqëria Balfin-Balkan Finance Investment Group.

**Shoqëria Target: SEASIDE RESIDENCE V SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti projektim dhe ndërtimi i objekteve civile apo industriale dhe menaxhimi i zbatimit të projekteve të kësaj natyre për vete dhe për të tretë, veprimtari ekonomike në fushën e turizmit, nëpërmjet ngritjes, operimit dhe administrimit të strukturave turistike pritëse ( akomoduese) dhe të gjitha shërbimet direkte apo indirekte të lidhura me to, si në tregun e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**